



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Procesverbal i Mbledhjes së III-të të KMCV

Nga mbledhja e tretë e KMCV mbajtur më 29.12.2021 me fillim në orën 11.00

Salla A/11, UKZ

Në mungesë të Kryesuesit Prof.Asoc.Dr. Xhevdet Thaqi, mbledhjen e hapi Fitore Malaj ,
Drjtoresha Zyrës për Cilësi e cila për këtë takim propozoi këtë:

Rend Dite

1. Aprovim i Raportit të Vlerësimit të Stafit Akademik nga ana e studentëve për Semestrin Veror 2020/2021
2. Raportim nga ZZHAC lidhur me realizimin e aktiviteteve të parapara në Kalendarin Vjetor për Sigurim të Cilësisë
3. Organizimi i Konferencës Shkencore 2022
4. Të ndryshme
 - a) Planifikimi i vlerësimit për Semestrin Dimëror 2021/2022 (Rishikimi i pyetesorëve etj)

Znj. Fitore Malaj propozoi që në të ndryshme të shtohet edhe një pikë lidhur me planifikimin e vlerësimit për semestrin dimëror.

Propozimi i rendit të ditës u hodh në votim dhe u miratua unanimitisht nga anëtarët e KMCV

Lidhur me pikën 1.Fitore Malaj, prezantoi ecurinë e procesit të vlerësimit, të gjeturat si dhe përmbledhjen e rezultateve në një raport të vetëm. Sipas saj rezultatet ishin mjaft të kënaqshme duke marrë parasysh të gjitha njësitë Akadematike. Gjithashtu edhe anëtarët e tjerë të Këshillit vlerësuan hartimin dhe analizën e raportit me detaje. Ata njëzëri aprovuan këtë raport.

Lidhur me pikën 2 drejtoresha e ZZHA Znj. Fitore Malaj, njoftoi anëtarët e KMCV me aktivitetet të cilat janë realizuar në këtë dymujorin të vitit akademik 2021/2022. Ajo prezantoi angazhimin e e të gjithë akterëve brenda universitetit e me theks të veçantë rolin e koordinatorëve të cilësisë nga të gjitha fakultetet të cilët janë edhe përgjegjës në shumicën e aktiviteteve.

Në kuadër të kësaj u hap diskutimi lidhur me rolin e bibliotekës dhe në procesin e hulumtimit dhe kërkimit shkencor.

Refik Ibrahim theksoi se biblioteka duhet të furnizohet me literaturë të cilën profesorët e përdorin për realizim të planprogramit mësimor. Ai propozoi që të formohet një komision që bën grumbullimin e syllabuseve dhe bën regjistrimin e librave fizik e elektronik e pastaj e kontrollon databazen e bibliotekës dhe evidenton mungesat.

Lidhur me këtë studentja Leurina Guda theksoi se përveç mungesës së literaturës në bibliotekë ka edhe mungesa elementare si : Internet, ndriçim etj. Gjithashtu studentja Sara Keçmezi potencoi edhe kohën e shfrytëzimit të bibliotekës, ajo kërkoi që biblioteka të jetë e hapur që nga ora 8:00 deri në 18:00 si dhe të jetë hapur edhe të shtunave.

Anëtarët prezent të KMCV-së njëzëri kërkuan që këto vërejtje të përcillen tek menaxhmenti i UKZ-së dhe të ndërmiren hapa për përmisim.

Lidhur me pikën 3 të rendit të ditës, drejtoresha e ZZHAC-së njoftoi të pranishmit në pika të shkurtëra me përgatitjet që kanë filluar të bëhen lidhur me organizimin e një konference shkencore në vitin e ardhshëm e cila do të përfshijë të gjitha njësitë akademike. Ajo theksoi se janë mbajtur dy takime janë formuar Këshilli Organizativ dhe Këshilli Editorial.

Në pikën 4 , në të ndryshme u diskutua për planifikim për vlerësimin e radhës , për semestër dimëror. Znj. Fitore Malaj theksoi se gjatë elaborimit të të dhënave të hulumtimit e ka parë të nevojshme që të rishikohen edhe pyetësorët që të mund të marrim një rezultat sa më real e përmbajtësor që të mund të nxjerrim rekomandime më të prekshme drejt përmisimit.

Prodekanja Fatmire Krasniqi propozoi që në përpunim të dhënave të potencohet edhe për numrin e studentëve që kanë vlerësuar një mësimdhënës, sepse ajo tha që nuk është e njëjtë të vlerësohesh si nga 80 studentë apo 8 studentë.

Këtë vërejtje e mirëpriti Znj. Fitore Malaj dhe theksoi se këtë

do ta ketë parasysh për të ardhmen.

Lidhur me këtë u diskutua edhe me vlerësimin e lëndëve dhe mësimdhënësve, Prodekani Bashkim Dalipi kërkoi që për këtë semestër pyetësori të jetë i përbashkët edhe për lëndë edhe për mësimdhënës. Kjo për shkak të praktikitetit nga ana e studentëve.

Refik Ibrahim propozoi që me qëllim që të bëjmë një krahasueshmëri të rezultateve të bëhet edhe një vlerësim me studentët bursiste të UKZsë.

Te gjitha rekomandimet e dala nga takimi ZZHA premtoi se do t'i marrë parasysh.

Procesmbajtësi

Fitore Malaj

Kryesuesi i KMCV

Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi